



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

#### **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 9.2.2021, ora 09:18

**Drejton mbledhjen:**

**Ilir Beqaj – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 124/2015 “Për eficiencën e energjisë”, të ndryshuar””. *(Komision përgjegjës)*

#### **Marrin pjesë:**

Ilir Beqaj, Besnik Baraj, Edmond Leka, Gjetan Gjetani, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Klajdi Qama, Kujtim Gjuzi, Halit Valteri, Nimet Musaj, Zef Shtejfi, Edmond Leka dhe Ilir Pendavinji.

#### **Mungojnë:**

Lefter Koka, Dritan Bici, Rrahman Rraja, Halil Jakimi dhe Arlind Çaçani.

#### **Të ftuar:**

Gjergji Simaku – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Laureta Dibra - Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Rudina Xhelilaj - Drejtoreshë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agron Haxhimali – Drejtor i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë

Romir Pajenga – Drejtor i Tarifave në Entin Rregullator të Energjisë

Rovalda Mema – Drejtor Juridik në Entin Rregullator të Energjisë

Eva Hyna – Këshilltare Juridike e Bordit Enti Rregullator të Energjisë

Erjon Tase – Drejtor në Akademia e Studimeve Politike

Elton Cerkezi – Përfaqësues i Shoqatës së Prodhuesve të Energjisë Diellore

Anduel Cerkezi - Përfaqësues i Shoqatës së Prodhuesve të Energjisë Diellore  
Evadiola Gjata – Përfaqësues i Shoqatës së Prodhuesve të Energjisë Diellore

## HAPET MBLEDHJA

**Ilir Beqaj** – Mirëmëngjesi kolege e kolegë deputetë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, data 09.02.2021, ora 09:18. Kuorumi është i mjaftueshëm për të filluar mbledhjen. Këtu me mua është edhe kolegja Gjermani.

Siç ramë dakord javën e kaluar, ne njoftuam disa grupe interesi, si Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë, Entin Rregullator, Shoqatën e Ndërtuesve, Akademinë e Studimeve Politike, Shoqatën e Prodhuesve të Energjive të Rinovueshme. Kanë konfirmuar që do të jenë pjesë e kësaj seance dëgjimore përfaqësues nga Shoqata e Bashkive, nga Enti Rregullator, nga Akademia e Studimeve Politike, gjithashtu, na ka ardhur edhe një tjetër sugjerim për të qenë prezent Shoqata e Prodhuesve të Energjisë Diellore. Ndërkohë, duke filluar që nga janari i këtij viti, edhe vetë Kuvendi i Shqipërisë, në kuadër të nxitjes së transparencës në komunikim me publikun, ka edhe një kanal të ri konsultimi publik, dhe për ligjet që lidhen me komisionin tonë ka bërë komente edhe Instituti i Politikave Mjedisore. Për ligjin në fjalë “Për eficiencën e energjisë” ka një koment në nenin 9/1, të cilin kur t’i vijë radha do ta dëgjojmë.

Elona, të lutem, konfirmoni të ftuarit!

Fjalën e ka kolegu Gjuzi.

**Kujtim Gjuzi** – Faleminderit!

Kemi 2 shoqata të bashkive. Shoqata që drejtohet nga zoti Agron Haxhimali, qenka këtu. Në rregull, ky ishte shqetësimi im.

Faleminderit!

**Ilir Beqaj** – Atëherë, meqenëse zoti Haxhimali është i pranishëm, i japim fjalën.

**Agron Haxhimali** – Mirëmëngjesi!

Unë e kam ndjekur me vëmendje dhe kam qenë pjesë e konsultimeve të mëparshme. Ju përgëzoj për faktin që ligji vjen në një kohë kur standardet dhe direktivat e BE-së për energjinë eficiente duhet të jenë pjesë e jetës sonë, e aktivitetit tonë, e industrisë së ndërtimit, duhet të jenë pjesë e planeve të aktiviteteve të strategjive të bashkive dhe të të gjitha institucioneve qendrore. Pra, duhet të punojmë në këtë drejtim.

Ajo që unë do të kërkoja është që ky ligj, sapo të miratohet, nuk duhet të mbetet thjesht në arkivat e bashkive, por duhet të ndërmerren një sërë masash të tjera, qoftë me nismën e parlamentit ose të qeverisë dhe ministrive përkatëse. Gjithashtu, edhe roli i shoqatave ka punën e vet, është më modest, por bashkitë dhe institucionet përkatëse ta marrin seriozisht zbatimin e këtij ligji. Ky ligj nuk duhet të flejë në zyrat e arkivat e bashkisë, por duhet të fillojë të zbatohet, pasi është normë, është standard.

Nga praktika që kemi në vendet e zhvilluara çështja e eficiencës së energjisë është njësoj si problemet sociale, si shëndeti, si shkolla. Pra, edhe ne duhet ta marrim seriozisht. A kanë bashkitë kapacitetet e duhura që ta konsiderojnë këtë punë? Unë mendoj se pas reformës territoriale kanë ndryshuar gjërat, kanë pasur një qasje më pozitive, por nuk duhet ta lëmë me kaq këtë çështje, pra unë mendoj se duhet të vazhdojnë trajnim dhe rritje kapacitetesh.

Së fundi, është çështja e faturës financiare. Në këtë drejtim zoti Simaku, që ka punuar nga ana e ekspertizës, mund të na thotë ndonjë gjë për të na iluminuar ne të gjithëve. Por, gjithsesi, është përgjegjësi e bashkive dhe duhet ta bëjnë me buxhetin e tyre ose të qeverisë, por ligji është koherent dhe gjen mbështetjen time të plotë.

Ju uroj punë të mbarë!

**Ilir Beqaj** – Faleminderit, zoti Haxhimali!

A keni komente për nene të caktuara!

**Agron Haxhimali** – Jo, nuk kam, sepse i kemi konsultuar në këshillin konsultativ.

**Ilir Beqaj** – Fjala për zonjën Mema.

**Rovalda Mema** - Ne nuk kemi ndonjë koment...

**Ilir Beqaj** – Nuk dëgjoheni.

A mund të dalësh nga lidhja dhe të riprovosh të lidhesh, të lutem?

Faleminderit!

Për momentin, më duket se e pashë edhe zotin Erion Tase, sikur ishte në linjë.

**Halit Valteri** - E ka lënë përfaqësuesin zoti Tase.

**Ilir Bejtja** – Ka konflikt interesi në këtë rast, nuk vlen.

**Halit Valteri** - Unë nuk do të votoj fare.

**Ilir Bejtja** – Shoh që në lidhje kemi edhe zotin Pajenga. Mund t'ia kalojmë fjalën?

Urdhëroni!

**Romir Pajenga** – Mirëdita!

Jam përfaqësues i Entit Rregullator të Energjisë, drejtor i Drejtorisë Tarifave.

Enti Rregullator nuk ka pyetje apo paqartësi lidhur me dokumentin, i cili është rregulluar, por, pavarësisht kësaj, mendoj se një përgjigje zyrtare me shkrim do t'i adresohet edhe Komisionit të Veprimtarive Prodhuese lidhur me tematikën, aprovimin apo edhe diskutimin për çështje të caktuara.

**Illir Bejtja** – A keni qenë pjesë e konsultimeve në hartimin e projektligjit?

**Gjergji Simaku** – A mund të bëj një sqarim?

Enti Rregullator dhe të gjithë operatorët e tjerë të sistemit elektroenergjetik kanë qenë pjesë e konsultimeve, pra janë marrë në konsideratë vërejtjet kryesore të tyre.

Unë doja të thosha se Enti Rregullator nuk ka qenë shumë aktiv në këtë projektligj, megjithëse ne kemi drejtuar shkresa lidhur me faktin që Enti Rregullator duhet të mendohet gjatë për ligjin për eficiencën, për arsye se ka shumë procese dhe problematika që kanë ndodhur në sistemin tonë elektroenergjetik.

Një nga problematikat është efienca e përdorimit të energjisë, pra përfshirja e operatorëve në eficiencën e energjisë. Secili nga operatorët qoftë prodhimi, transmetimi apo shpërndarja duhet t'i nënshtrohen procesit të auditimit të energjisë, çka do të thotë se për pjesën e menaxhimit të rrjetit duhet që OSSH-ja të kryejë një proces auditimi të kësaj natyre. Çka dua të them është që të zbulojë në mënyrë teknike, pavarësisht nga fakti se sa mund të jetë ky lloj projekti, se cilat janë humbjet teknike në rrjet, me qëllim adresimin e investimeve.

Gjithsesi, pa i vënë emrin ligji “eficiencë energjisë”, që është detyrim për ta bërë, se ky është një konsumator i madh, llogarisim që kemi të paktën 15% humbje të energjisë nga pikëpamja e komunikimit dhe transmetimit në rrjet, ata duhet t'i nënshtrohen procesit të auditimit. Gjithsesi, ky auditim po bëhet përmes konsulentëve, por nuk e ka emrin “eficiencë energjie” apo “auditim për eficiencën e energjisë”.

Enti Rregullator në këtë proces është aktiv. Kemi komunikuar për këtë çështje.

Faleminderit!

**Illir Bejtja** – Faleminderit!

Fjala për zotin Tase.

**Erjon Tase** – Mirëdita!

Faleminderit, për ftesën!

Më vjen mirë që edhe me anëtarët e komisionit ritakohemi, edhe pse *online*, pas një periudhe shkëputjeje për shkak të kushteve të pandemisë.

Në pjesën e ndryshimeve në ligjin “Për eficiencën e energjisë” kemi qenë që nga viti 2015 pjesë e diskutimeve dhe gjatë kësaj periudhe, përveç faktit që kemi konstatuar sa shpejt kalon koha, shumë prej gjërave që kemi diskutuar në vitin 2015 kanë mbetur pa u zbatuar, çdo ndryshim që vjen nga ministria përkatëse dhe politikbërësit përkatës është i mirëpritur për të sjellë ato zbatime dhe masa të pritshme që kërkohen për politikën e eficiencës së energjisë.

Pyetje që mund të kemi dhe që do të doja të shtroja është ajo për të cilën kemi luftuar së bashku me zotin Simaku në vitin 2015, ngritjen e fondit të eficiencës së energjisë, që me ndryshimet aktuale ose në relacionin që ndoqa, duket se kemi një farë tërheqjeje apo dorëzim nga sfidat për ta ngritur këtë fond dhe për të tentuar sërish ta bëjmë sa më të prekshëm për investimet në sektorin e energjisë.

Ndryshimet aktuale apo e ardhmja do të jetë që nuk do të ngrihet fondi? Do të kemi tërheqje? Unë këtë pyetje kisha, së pari.

Duke qenë se edhe ndryshimet në nenin 9 apo masa të reja që parashikohen, skema detyruese për sektorët publikë dhe prodhuesit e mëdhenj të energjisë ose motorët e mëdhenj të energjisë, parashikohen edhe skema alternative që janë vendosja e taksës së karbonit apo taksave të tjera dhe shumë mirë këto taksa mund të shkonin te fondi kombëtar i eficiencës së energjisë për të krijuar atë fond të nevojshëm që mund të duhet edhe për bashkitë, të cilave po u kërkojmë plane vendore për eficiencën e energjisë, edhe tek institucionet e tjera publike të cilave do t’u kërkojmë që shumë shpejt të kenë detyrime për të investuar në termoizolim apo masa të tjera të eficiencës së energjisë.

Me këto standarde ose me këto afate kohore që janë vendosur thjesht shqetësimi mbetet se sa do të jetë i aftë buxheti i shtetit të përballojë investimet e nevojshme dhe ku do të gjenden këto investime.

Faleminderit!

**Ilir Beqaj** – Zoti Simaku, a mund të përgjigjeni?

**Gjergji Simaku** – Absolutisht, po.

Ne vërtet kemi ndarë një shqetësim të kësaj natyre për shkak të përpjekjeve tona disavjeçare për të krijuar një fond. Ne e trajtuam këtë çështje edhe në seancën e mëparshme me

ju. Mendojmë që fondi ishte i pasuksesshëm dhe në vitet e ardhshme mund të mbetet i pasuksesshëm.

Kështu që, në analizë të ligjit në teknikat ligjore ne ndoqëm linjën e detyrimit. Meqenëse bashkitë apo institucionet shtetërore janë konsumatorë të mëdhenj të energjisë, atëherë skema detyruese mund të funksionojë dhe ne jemi për skemën detyruese për arsye se kjo skemë detyruese do të shtrihet jo vetëm në sektorin privat, siç është sot, por edhe në sektorin publik, mjafton të jesh konsumator i 1 milionë kilovatorëve në vit.

Ne këtë gjë e kemi konsultuar edhe me Komisionin European, edhe me reformat ekonomike, me programin e reformave ekonomike dhe kemi zgjedhur të mos ndërtojmë një fond, por të forcojmë politikat dhe të forcojmë implementimin e ligjit përmes institucioneve. Besoj fort se kjo gjë do të ndodhë.

E dyta, kishte të bënte me skemat detyruese, të cilat mund të financohen nga taksa e karbonit. Unë ju bëj me dije që ne kemi filluar dhe jemi në përfundim të politikave dhe implementimit të politikave në planin e ri që po bëjmë për klimën dhe energjinë, i cili është një plan i integruar. Ne i kemi identifikuar këto politika dhe masa që do të marrim për këtë çështje dhe këto do t'i kostojmë. Pra, skemat detyruese do të jenë në nivelin më të lartë, gjithashtu, sikurse edhe e kemi përmendur në ligj, pavarësisht faktit se personalisht nuk kam qenë shumë dakord me këtë, që bashkitë të bëjnë plane vendore, sepse bashkitë për këto plane vendore do të kërkojnë financimet përkatëse. Tani duhet të zgjedhim midis faktit që të financojmë bashkitë për të implementuar planet e tyre vendore apo të zgjedhim skema detyruese ku bashkitë automatikisht futen në këto skema detyruese, janë konsumatorë të mëdhenj.

Pra, ky është pak a shumë diskutimi që personalisht dëshiroja të bëja. Nuk e kam votën pro për këtë çështje, për arsye se jo të gjitha bashkitë mund të plotësojmë kushtet për të vendosur plane vendore. Bashkitë do të kenë menaxherët e tyre dhe do të inkludojnë në skemën detyruese. Kështu që planet automatikisht (*shkëputje*)...

**Illir Beqaj** – Urdhëroni, zoti Çekrezi, përfaqësues i Shoqatës Prodhuese të Energjisë Diellore!

**Elton Çekrezi** – Mirëmëngjesi, të nderuar deputetë!

Unë përfaqësoj një grup interesi, i cili për vetprodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, pra nga dielli (koncepti i vetprodhimit dhe jo i prodhimit).

**Illir Beqaj** – Zoti Çekrezi, pra ju jeni vetprodhues apo prodhues?

**Elton Çekrezi** – Ne jemi vetprodhues.

E bëra këtë parantezë për ta lidhur edhe me pjesën e ndryshimeve ligjore që po diskutojmë sot. Në fakt, nga të gjitha këto ndryshime (unë ftesën e mora pak vonë, ndoshta për arsye të organizimit dhe nuk patëm kohë të bënim sugjerime dhe ndryshime përkatëse që mund të reflekttoheshin, por ajo që doja të theksoja është se synimi i këtij ligji është të shkojmë drejtë ndërtesave me eficiencë të lartë energjetike dhe, pse jo, me zero energji dhe, në fakt, nuk e di se si mund të bëhet ndryshe pa përfshirë edhe konceptin e vetprodhimit të energjisë elektrike, e cila do të ishte e mirintegrueshme, qoftë edhe në këtë ligj apo në ligjin e eficiencës, edhe pse e kemi pjesërisht te ligji i nxitjes së përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme.

Në këndvështrimin tim do të duhej të ishte i përcaktuar mirë edhe në këtë drafligj, siç mund të ishte edhe krijimi i disa mekanizmave që mund të ishin lehtësuese, të paktën për pjesën e përdorimit rezidencial apo qoftë edhe përdorimit industrial të këtyre teknologjive, sepse sado të rrisim eficiencën, sado të japim mekanizma për të rritur eficiencën, përsëri kemi parë jashtë se arrihet deri në një pikë që ka nevojë që ato ndërmarrje apo ata konsumatorë energjie të mëdhenj apo të vegjël të vetëprodhojnë një pjesë të kësaj energjie nga burimet e rinovueshme, siç është dielli apo era e burime të kësaj natyre.

Nëse jam koherent, do të doja të kemi në këtë kërkesë disa parashikime, në mënyrë që kjo gjë të lehtësohej, të paktën për disa grupe konsumatorësh.

**Ilir Beqaj** – Zoti Gjuzi, urdhëroni!

**Kujtim Gjuzi** – Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti Çekrezi, ju sapo diskutuat ose zgjeruat gamën e projektit. A keni një propozim konkret, për një nen konkret të projektit?

Faleminderit!

**Ilir Beqaj** – Zoti Çekrezi, nuk dëgjoheni!

**Elton Çekrezi** – Po tani? Dakord.

Shumë e drejtë pyetja, zoti Gjuzi. Siç e thashë, ftesën e kam marrë mbrëmë dhe nuk kam arritur dot të përgatis një draft apo një nen konkret për ndryshime. Nëse do të kem kohë, nuk e di se sa është koha e limituar, por mund t'ju paraqes ndryshimet konkrete, të paktën deri në fund të javës, pra nëse do të keni kohë të mjaftueshme.

**Ilir Beqaj** – Urdhëroni, zoti Gjuzi!

**Kujtim Gjuzi** – Zoti kryetar, faleminderit!



Zoti Çekrezi, gjatë kohës që ne kalojmë projektligjin nen për nen, besoj se do të keni inteligjencë të ndërhyini në momente të caktuara, ku ne pastaj mund të japim bonsens për të parë ndërveprimin në lidhje me projektin. Kurse për kërkesën e shtyrjes së afatit, kjo është në dorën e maxhorancës dhe të kryetarit.

**Elton Çekrezi** – Mund ta bëjmë, por, nëse do të ishte e mundur edhe një shtyrje, duke qenë se dje jam njohur me këto ndryshime. Gjithsesi, si ta vlerësoni ju, zoti kryetar.

**Gjergji Simaku** – A mund ta sqaroj zotën Çekrezi?

**Illir Beqaj** – Zoti Simaku, nuk ka nevojë.

Praktikisht nuk ka më grupe interesi që kanë diçka konkrete për të shprehur. Kolegë, do t'ju ftoja të kalojmë në diskutimin nen për nen. Jemi gati?

Zoti Pëllumbi, urdhëroni!

**Arben Pëllumbi** – Faleminderit, zoti kryetar!

I dëgjova të gjithë të ftuarit sot dhe besoj se në parim jemi të gjithë dakord për kalimin e këtij projektligji. Nuk shoh askënd të ketë vërejtje për esencën, të cilën dëshiron të sjellë në veprim ky lloj projektligji. Për këtë arsye ne mund ta kalojmë në parim projektligjin, pastaj të fillojmë diskutimin nen për nen.

**Illir Beqaj** – E kemi votuar në parim herën e kaluar. Sot do të diskutojmë bashkërisht nëse jeni gati të fillojmë nen për nen apo do ta zhvillojmë një ditë tjetër? Vetëm kjo është pyetje për sot.

**Kujtim Gjuzi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë, besoj se ne gjatë gjithë kohës që kemi qenë së bashku në raste të tilla, kemi marrë shënime nga grupeve të interesit. Meqenëse zotëria kërkon një afat, normalisht afati 4-5 ditë është i pamundur. Unë mendoj se 24 orë ndoshta do t'i mjaftonin zotërisë ta shikonte me grupin e tij të ekspertëve. Ky është propozimi im.

**Besnik Baraj** – A mund të shtoj diçka?

**Illir Beqaj** – Patjetër!

**Besnik Baraj** – Faleminderit!

Meqenëse sot më orën 10:00 organizohet një konferencë ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe parlamentit, nëse është e mundur, do të sugjeroja edhe unë të shtyhet diskutimi.

**Illir Beqaj** – Kolegë, keni komente të tjera?

Si mendoni ta shqyrtojmë nen për nen ditën e premte apo javës tjetër?

**Kujtim Gjuzi** - Ditën e premte që ta mbyllim brenda javës.

**Illir Beqaj** – Ka shumë nene dhe nuk e mbyllim dot për një ditë. Praktikisht, nga përmbajtja, zëre se është një ligj i ri.

**Kujtim Gjuzi**- Atëherë, si të bien dakord kolegët.

**Illir Beqaj** – Urdhëroni, zoti Marto!

**Andrea Marto** – Do të propozoja ta zhvillojmë mbledhjen ditën e hënë, sepse ditën e premte jemi zakonisht të gjithë nëpër zona.

**Illir Beqaj** – Në parim jemi për ditën e hënë. Nëse do të ketë seancë plenare, do ta zhvillojmë mbledhjen ditën e martë. Kam vetëm një kërkesë, nëse do ta zhvillojmë mbledhjen ditën e hënë, ta lëmë në orën 10:30 dhe jo në 10:00 për disa angazhime të miat.

**Kujtim Gjuzi** – E ke bonsensusin nga opozita.

**Illir Beqaj** – Dakord.

Atëherë, do t'ju njoftojmë nga fillimi i javës së ardhshme se kur do ta zhvillojmë mbledhjen.

Faleminderit për sot!

Ndërkohë, të gjitha grupet e interesit do të kenë kohë për të na i dërguar me shkrim edhe komentet e tyre.

Ditë të mbarë!

Mbyllim mbledhjen!

## **MBYLLET MBLEDHJA**